



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
NJËSIA QËNDRORE E HARMONIZIMIT TË  
MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Nr. 2066 Prot.

Tiranë, 31.08.2011

Për: Institucionin \_\_\_\_\_

**Subjekti: Caktimi i Nepunesve Autorizues ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme**

Ne vijim te shkreses Nr. 6082, date 16.03.2011 lidhur me hapat qe duhen ndjekur per zbatimin e Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, si dhe perfundimit te periudhes tranzitore 3 vjecare te percaktuar ne paragrafi 1 te nenit 74 te Ligjit Nr 9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", Titullaret e njesive te qeverisjes qendrore dhe vendore dhe fondeve speciale te marrin te gjitha masat per zbatimin e kerkesave ligjore ne fushen e menaxhimit te financave publike.

Ne kuptim te nenit 4, pika 22 te Ligjit "Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Titullaret e njesive te qeverisjes se pergjithshme konsiderohen Ministrat, Kreret e Institucioneve te Pavarura, Kreret e Fondeve Speciale, Kryetaret e Bashkive, Komunave dhe Keshillave te Qarqeve.

Titullaret e njesive si me lart te caktojne Nepunesin Autorizues te njesise publike, Nepunesit Autorizues te Nivelit te dyte dhe te njoftojne Nepunesin e Pare Autorizues ne Ministrine e Financave brenda muajit Nentor te ketij viti.

Ne kuptim te nenit 19 te Ligjit "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor te RSH", Nepunesi Autorizues i njesise publike eshte sekretari i pergjithshem ne Ministri/ose punonjesi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil per institucionet e tjera qendrore/ose menaxheri i nivelit me te larte ne njesite e tjera publike ne vartesi direkte te titullarit. Nepunesit Autorizues te nivelit te dyte jane drejtuesit e njesive te vartesis, te cilave u akordohet buxhet me vehte.

Bashkelidhur do te gjeni nje dokument referues mbi kompetencat e Titullarit dhe te Nepunesit Autorizues te njesive publike, bazuar ne kerkesat e ligjeve te siperpermendura.

Ridvan BODE



## **Pergjegjesite**

# **TITULLARIT dhe NËNPUNËSIT AUTORIZUEZ TË NJËSISVE PUBLIKE**

Duke iu referuar kerkesave te Ligjit Nr. 9936, date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit Nr 10296 datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit (MFK)” ne kete material jane listuar disa nga pergjegjesite kryesore te Titullarit dhe Nepunesit Autorizues ne njesite publike:

### **TITULLARI I NJËSISË PUBLIKE**

“Titullar i njësisë publike” është kreu i organit qendror të njësisë publike<sup>1</sup>. Ne kete kuptim Titullare jane Ministrat, Kreret e Institucioneve te Pavarura, Kryetaret e Bashkive, Komunave dhe Keshillave te Qarkut, Kreret e Njesive te Fondeve Speciale.

#### **I. Te pergjithshme**

1. Përgjigjet për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësise publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit ne perputhje me kerkesat e Ligjit “Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (kreu i dyte dhe i trete).
2. Cakton nëpunësin autorizues, sipas përcaktimeve të nenit 19 te Ligjit 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe përcaktimeve te nenit 8 paragrafi 3,4 te Ligjit “Per MFK”<sup>2</sup>.
3. Përgjigjet për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit te fondeve te BE, ne rast se zbaton detyra që lidhen me shpenzimin apo menaxhimin e fondeve të Bashkimit European, ose kryen funksionin e organit ndërmjetës të këtyre fondeve.<sup>3</sup> (Neni 8, paragrafi 6 Ligji per MFK).
4. Nënshkruan udhëzime ose marrëveshje të përbashkëta me titullare te tjere te njesive publike lidhur me pjesën e përgjegjshmërisë menaxheriale që do të mbajë secili prej

---

<sup>1</sup> Neni 4, paragrafi 22 I ligjit 10296, date 8.07.2010 “Per Menaxhimin Financia rdhe Kontrollin”

<sup>2</sup> Neni 8, paragrafi 5 I Ligjit per MFK citon: Drejtuesit e të gjitha niveleve të njësive të varësisë i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, deri tek titullari i njësisë publike, dhe janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientë. (Drejtuesit jane njekohesisht Nepunes Autorizues te nivelit te dyte sipas ligjit 9936)

<sup>3</sup> Ne perputhje me kerkesat e Ligjit Per MFK dhe të rregulloreve përkatëse të Bashkimit European.

tyre gjatë zbatimit të programeve, që përfshijnë më shumë se një njësi dhe/ose strukturë të sektorit publik. (neni 8, p 7 ligji per MFK)

## **II. Kompetencat e detajuara te Titullarit ne fushen e menaxhimit financiar dhe kontrollit**

Titullari i njësise publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit ka këto kompetenca kryesore, sipas nenit 8, Pg 8 i ligjit per MFK:

1. hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ai drejton, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;
2. ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili perbehet nga menaxheret kryesore te njesise publike dhe kryesohet nga ai vete<sup>4</sup>. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje..
3. miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;
4. miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre;
5. miratimin e sistemit të rregullave specifike e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar ne udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Financave;
6. rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;
7. futjen e procedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi;
8. sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

## **III. Kompetencat ne Procesin e Buxhetimit**

9. Cakton dhe njofton nëpunësin e parë autorizues<sup>5</sup> për nëpunësin autorizues të njësisë qe mbulon.
10. Miraton Deklaraten e Politikave te Buxhetit Afatmesem dhe Vjetor te njesise publike (ne kuadrin e kompetencave te paragrafit II/1)
11. Miraton me propozim te Nepunesit Autorizues, punonjës të administratës publike si nëpunës autorizues të nivelit të dytë në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes qendrore.
12. Drejton procesin e hartimit te dokumentit te buxhetit afatmesem dhe vjetor te njesise publike dhe e miraton ate, me propozim te Nepunesit Autorizues, perpara dergimit ne Ministrine e Financave.

---

<sup>4</sup> Ish GSBI quhen tashme GMS duke perfshire pervec procesit te buxhetimit edhe diskutimin dhe marrjen e masave per ceshtje qe dalin gjate procesit te menaxhimit financiar dhe kontrollit per MFK

<sup>5</sup> Nepunesi I Pare Autorizues eshte Sekretari I Pergjithshem ne MInistrine e Financave. Neni 18 i ligjit 9936 Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”

#### **IV. Kompetencat e Titullarit ne procesin e zbatimit te buxhetit**

13. Monitoron zbatimin e buxhetit referuar politikave, objektiveve, produkteve dhe impaktit te tyre (outcome) te miratuara prej tij gjate procesit te buxhetimit.
14. Monitorimi kryhet nepermjet kerkeses se llogarise ndaj Nepunesit Autorizues, duke vendosur menyren e raportimit mbi baze performance si dhe frekuencen e raportimit.
15. Merr pjese aktive ne vendimet strategjike te menaxhimit nepermjet kryesimit te mbledhjeve te Grupit te Menaxhimit Strategjik.
16. Monitoron sistemet e kontrollit te brendshem nepermjet Auditimit te Brendshem.
17. Jep/ rikonfirmon Urdher me shkrim Nepunesit Autorizues (NA), lidhur me menaxhimin operacional, te shoqeruar me argumentimin perkates (nese ka patur me pare nje kundershtrim me shkrim nga NA lidhur me shkeljen e dispozitave per menaxhimin financiar).<sup>6</sup>
18. Ka te drejte ti kerkoje inspektim financiar Ministrin te Financave ose direkt Nepunesit te Pare Autorizues per verifikimin e parregullsive sipas procedurave te ligjeve ne fuqi dhe te kryeje investigim te brendshem me kerkese te NPA<sup>7</sup>.

### **NËNPUNËSI AUTORIZUES**

“Nëpunës autorizues” është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset që menaxhohen prej tyre<sup>8</sup>.

#### **I. Te pergjithshme**

1. Eshhtë përgjegjës dhe raporton tek titullari i njësisë publike dhe nepunesi i pare autorizues për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit<sup>9</sup> në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.
2. I propozon titullarit të njësisë publike akte të brendshme administrative, monitoron dhe përditëson sistemet për menaxhimin financiar dhe kontrollin e njësisë publike, brenda kuadrit rregullator të Ministrisë së Financave, si dhe merr masa për

---

<sup>6</sup> Shih nenin 21 te Ligjit 9936 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH”

<sup>7</sup> Ligji per MFK dhe Ligji 10294, date 1.07.2010 “per inspektimin financiar publik”

<sup>8</sup> Nepunesi Autorizues eshte Sekretari pergjithshem ne Ministri/ose punonjesi i administrates publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil per institucionet e tjera qendrore/ose menaxheri i nivelit me te larte ne nje njesite e tjera publike ne vartesi direkte te titullarit.

<sup>9</sup> Rregullat e ndertimit te tyre jane vendosur me Ligjin 10296 per MFK, Kreu I dyte dhe I trete

përmirësimin e sistemeve, në vijim të rekomandimeve të auditimit të brendshëm, auditimit të jashtëm dhe të vlerësimeve e të analizave të tjera.

3. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë<sup>10</sup> janë përgjegjës dhe i raportojnë nëpunësit autorizues, sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë.

## **II. Kompetencat e detajuara te Nepunesve autorizues te te gjitha niveleve ne fushen e menaxhimit financiar dhe kontrollit**

Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore sipas nenit 9 te ligjit per MFK:

1. propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi;
2. hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësisë publike;
3. monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë;
4. caktimin dhe shkarkimin e nëpunësit zbatues. Shkarkimi i nëpunësit zbatues kryhet vetëm pas marrjes së mendimit paraprak nga nëpunësi i parë autorizues në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve;
5. planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësisë publike;
6. mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional<sup>11</sup> për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
7. krijimin e kushteve për menaxhim të ligjshëm, efektiv e të përshtatshëm dhe për sjellje etike të punonjësve të njësisë;
8. monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;
9. ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.
10. NA i cdo niveli eshte koordinator i riskut te njesise, pergjegjes per (i) bashkerendimin e veprimtarive qe lidhen me identifikimin dhe vleresimin e risqeve si dhe ngritjen e

---

<sup>10</sup> P.sh Ministria e Financave ka tre nivele te njesive te vartesis: Qendra, DPPolicise, Drejtorite Rajonale  
DRP dhe Komisariatet me buxhet me vehte. Drejtuesit e DPP, DRP, Komisariateve jane Nepunes Autorizues  
te nivelit te dyte. Ata raportojne ne shkalle hierarkike Komisariati →DRP →DPP →Nepunesi Autorizues i  
MB→NPA ne Min e Financave

<sup>11</sup> Trajnim i vazhdueshem ne forma te ndryshme

sistemit për minimizimin e tyre; (ii) keshillimin për menaxheret në bashkëpunim me NJQH/MFK; (iii) paraqitjen e raportit të risqeve për njësinë tek Titullari dhe Grupi për Menaxhimin Strategjik.

11. Nëpunësi autorizues ka të drejtë delegimi të disa prej të drejtave të tij tek menaxheri i vartësisë direkte, por duke ruajtur nivelin e përgjegjësisë.<sup>12</sup>
12. NA nuk ka të drejtë delegimi të të drejtave të tij tek Nënpunësi Zbatues i njësisë, veçanërisht për autorizimin e transaksioneve financiare, .
13. NA i çdo niveli nuk ka të drejtë delegimi të përgjegjësisë si më poshtë:
  - a. propozimin të nëpunësi autorizues i nivelit më lart, apo tek Titullari i njësisë publike, të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi;
  - b. caktimin dhe shkarkimin e nëpunësit zbatues.
  - c. mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
  - d. ndarjen e përgjegjësisë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.
14. NA në bazë të vetvlerësimeve depoziton tek titullari i njësisë publike dhe tek NPA një deklaratë vjetore dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon për vitin e mëparshëm, jo më vonë se muaji shkurt i vitit korrent<sup>13</sup>. Në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi sanksionohet nga NPA sipas ligjit 10296 “Për MFK”.
15. Për të realizuar përgjegjësinë si më lart NA duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e vartësisë, për të mbështetur deklaratën e cilësisë.

### **III. Kompetencat në fushën e buxhetimit**

16. Propozon tek Titullari punonjës të administratës publike si nëpunës autorizues të nivelit të dytë në secilën nga njësitë vartëse të njësisë së qeverisjes qendrore, të cilave u caktohet buxhet me vehte
17. Përgatit dhe dorëzon kërkesat për programin buxhetor afatmesëm dhe kërkesat shpeshë, në përputhje me politikat dhe objektivat e vendosura nga titullari dhe kërkesat dhe afatet e parashikuara në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave.
18. Udhëzon dhe informon nëpunësit zbatues të njësisë shpenzuese të varësisë dhe garanton zbatimin e udhëzimeve të dhëna prej tij nga nëpunësit zbatues të njësisë shpenzuese që ka në juridiksion.

---

<sup>12</sup> Delegim i disa prej të drejtave (firma) nuk nënkupton delegim të përgjegjësisë. Neni 15 I ligjit për MFK

<sup>13</sup> Që të realizojë këto detyra duhet të vihet vazhdimisht në dijeni nga Auditi i Brendshëm për gjetjet lidhur me sistemet e kontrollit të brendshëm dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e tyre.

19. Brenda datës 1 shtator të çdo viti, paraqet te nëpunësi i parë autorizues kërkesat e rishikuara të programit buxhetor afatmesëm dhe kërkesat shtesë, me argumentet përkatëse.
20. Detajon fondet për njësitë shpenzuese, në përputhje me shpërndarjen e fondeve buxhetore, të miratuara nga Ministri i Financave dhe përparësitë e njësive të qeverisjes së përgjithshme si dhe e paraqet tek NPA.
21. Miraton rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese. Vihet në dijeni sipas rastit NPA (për njësitë qendrore).
22. Paraqet pranë nëpunësit të parë autorizues kërkesë për fonde shtesë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe që nuk mund të shtyhen për vitin buxhetor pasardhës.
23. Propozon planin e arkës tek NPA për miratim. Nëpunësi autorizues është përgjegjës për respektimin e planit të arkës të miratuar dhe për argumentimin e çdo rishikimi ose moszbatimi të tij, sipas kriterëve të vendosura në udhëzimin e zbatimit të buxhetit.

#### **IV. Kompetencat e NA gjatë procesit të zbatimit të buxhetit**

24. Pas miratimit të detajimit të fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese, merr angazhime<sup>14</sup> dhe urdheron pagesat, brenda limiteve dhe afateve të përcaktuara.
25. Mban të dhëna për angazhimet financiare dhe nuk lejon ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara, ndryshe është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit.
26. Raporton tek titullari në mënyrë të rregullt dhe sa herë që i kërkohet lidhur me performancën financiare gjatë zbatimit të buxhetit, për produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program/ aktivitet risqet e minimizuara, problemet e hasura masat që ka marrë ose që duhen marrë, etj.
27. Në rastet kur Titullari jep ose rikonfirmon me shkrim urdhrin që lidhet me manaxhimin operacional (të kundërshtuar me parë nga NA), nëpunësi autorizues procedon me zbatimin e urdhrin dhe një kopje të raportit të kundërshtimit e dërgon te nëpunësi i parë autorizues, i cili vë në dijeni Ministrin e Financave. Me konfirmimin me shkrim të urdhrin, në rastin e komunikimeve ndërmjet Ministrin të Financave dhe nëpunësit të parë autorizues, një kopje e raportit dërgohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit<sup>15</sup>.

---

<sup>14</sup> Neni 43 I ligjit 9936 dhe neni 22 I ligjit 10296

<sup>15</sup> Shih nenin 21 të ligjit 9936, datë 26.06.2008

28. Jep/rikonfirmon Urdher me shkrim Nepunesit Zbatues<sup>16</sup>, lidhur me menaxhimin operacional, te shoqeruar me argumentimin perkates (nese ka patur me pare nje kundershtim me shkrim nga NZ lidhur me shkeljen e dispozitave per menaxhimin financiar). Ne kete rast NZ e paraqet Urdherin e kundershtimit ne Thesar se bashku me praktiken e shpenzimit.<sup>17</sup>
29. Pergjigjet per funksionimin e sistemit te kontabilitetit, ne perputhje me ligjin 9936 dhe aktet e tjera ne zbatim te tij dhe me udhezimet e Ministrit te Financave.
30. Ne fund te vitit deponon ne sistemin e thesarit raporte financiare, sipas percaktimeve te nepunesit te pare autorizues, per pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore te qeverisjes se pergjithshme.
31. Finalizon dhe konfirmon perfundimisht me nepunesin e pare autorizues pasqyrat financiare vjetore te buxhetit, brenda dates 31 mars te vitit pasues.
32. Pergjigjet per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve financiare, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.
33. I paraqet sa here qe kerkoet, por jo me pak se katër here ne vit, nepunesit te pare autorizues raportet e monitorimit te zbatimit te buxhetit per performancen financiare, produktet dhe objektivat e realizuar per çdo program te percaktuar ne vitin e pare te dokumentit perfundimtar te programit buxhetor afatmesëm.
34. NA ka te drejte te kerkoje inspektim financiar NPA per parregullsi sipas procedurave te ligjeve ne fuqi dhe te kryeje investigim te brendshem me kerkese te NPA.

---

<sup>16</sup> Drejtuesi pergjegjes per financat ne vartesi direkte te Nepunesit Autorizues. Neni 20 i ligjit 9936 dhe neni 12 i ligjit per MFK

<sup>17</sup> Shih nenet 13,14 te ligjit per MFK